



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.438/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet e pabazuara ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.438/2025, e datës 07.02.2025.

Paraqitur kundër Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelktualët, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë e identifikuar me numër Anr.438/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelktualët, me të cilën pretendohet se me 6 Shkurt 2025, kandidati për deputet i Koalicionit AAK-NISMA, z.Fatmir Limaj, në tubimin elektorale të mbajtur me qytetarë në Rahovec ndër të tjera ka deklaruar: *"Rahovec largohu nga mashtrimi dhe shpifja për 4 vite Kosova ka përjetuar përçarje polarizimi për 4 vite ju kane qeverisur zhurmagjinjet"*

Sipas parashtruesit të ankesës me këto veprime kandidati i koalicionit AAK-Nisma, për Zgjedhjet Parlamentare të datës 09.02.2025 z.Fatmir Limaj, ka shkelur dispozitat e nenit 34

pika 1.11 e LZP-së, duke përhapur gjuhë të urrejtjes dhe shpifjes që do të mund të nxiste sulm ndaj të tjerëve .

Duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojnë nga PZAP-i që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ankesës si Provë kanë bashkangjitur CD – të deklaramit të lartcekur.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelktualët, lidhur me pretendimet në ankesë theksojnë se në asnjë moment z. Limaj në tubimin e mbajtur ne Rahovec, nuk është përdorur gjuha e cila ndalohet apo sanksionohet me dispozitat e nenit 34 te LZP-se dhe se ne asnjë moment përmes deklarimeve nuk nxit dhunë apo fyerje ndaj te tjerëve. Në vazhdim theksojnë se një deklaram i tillë ka qenë brenda kufijve të lirisë së shprehjes dhe për me tepër brenda kuadrit të një propagande zgjedhore e cila është edhe një nga parimet themelore dhe demokratike të fushatës zgjedhore e përcaktuar me dispozitat e nenit 4, par 1, nënpar 1.5 të LZP-së. Kërkojnë nga PZAP-i, që ankesa në fjalë të refuzohet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se kandidati për deputet nga Koalicioni AAK-NISMA, Konservatorët, Intelktualët, z.Fatmir Limaj në tubimin e mbajtur në Rahovec ka deklaruar se: *“Rahovec largohu nga mashtrimi dhe shpifja per 4 vite Kosova ka përjetuar përçarje polarizimi per 4 vite ju kane qeverisur zhurmagjinjet”* Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe nxitje të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nga kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik z. Fatmir Limaj, nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen, në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Andaj, bazuar në provat e ofruara ka ardhur në përfundim se me fjalët e thëna gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore të mbajtur me datë 06.02.2025 në qytetin e Rahovecit, të cekura më

lartë nga kandidati për deputet nga radhët e Koalicionit AAK-NISMA, Konservatorët, Intelktualë, Paneli ka vlerësuar se nuk bie në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP- së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.438/2025 më datën 10.02.2025

Kryesuese e Panelit
Voleta Musaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.